


DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Inagurohet Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Korçë, me pjesëmarrjen e Ministrit të Drejtësisë, z.Ulsi Manja, Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, z.Ergys Qirici, përfaqësueses së UNDP zj. Monica Merino dhe Ambasadorit të Austrisë në Shqipëri Dr.Christian Steiner.



U hodh shorti dhe u hartua lista me avokatët e përzgjedhur nga shorteu, në ambientet e Dhomës Kombëtare të Avokatisë, mbi bazën e interesit të shprehur nga avokatët në rang kombëtar, për ofrimin e Ndihmës Ligjore Falas.

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mori pjesë në seminarin e mbajtur në Shkodër "Fuqizimi i grave dhe vajzave përmes rritjes së aksesit në të drejtat ekonomike, ligjore dhe sociale", në kuadër të programit "Barazia gjinore në aksesimin e mundësive ekonomike" zbatuar nga Expertise France, financuar nga AFD (Agence Française de Développement).





BULETINI INFORMATIV

JANAR 2024

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Pogradec

Në datën 12.01.2024, QSHNJP Pogradec, mori pjesë në takimin me temë “Gruaja, Paqja, Siguria – Zbatimi i Agjendës Kombëtare në vend”

Në datën 30.01.2024, QSHNJP Pogradec, në bashkëpunim me psikologjen e Gjimnazit "M.Çollaku" dhe Zyrën e Shërbimit të Provës, Pogradec kanë organizuar një takim të përbashkët me nxënës të kësaj shkolle.



Përmet

Në datën 29.01.2024, QSHNJP Përmet, zhvilloi një aktivitet informues në qendrën e qytetit me punonjëset e sektorit të Pastrim-Gjelbërimit.



Përmet & Gjirokastrë

QSHNJP Përmet & Gjirokastrë vijnë bashkëpunimin në promovimin e ndihmës juridike. Në datën 30.01.2024, u zhvillua aktivitet promovues dhe informues pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, Prokurorisë Gjirokastrë, si dhe Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Gjirokastrë.



Berat

Në datën 31.01.2024, QSHNJP Berat, zhvilloi një aktivitet ndërgjegjësues/informues me qytetarë të ndryshëm në qytetin e Beratit (Street low).

Lezhë

Në datën 11.01.2024, QSHNJP Lezhë, mori pjesë në takimin e organizuar nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, Bashkia Lezhë.



Tiranë

Në datën 23.01.2024, QSHNJP Tiranë, realizoi një aktivitet me banorët e Njesisë Bashkiake Nr. 1 & 2, duke informuar qytetarët për shërbimet e ofruara nga Qendra e Ndihmës Juridike Parësore.

Korçë

Në datën 18.01.2024, QSHNJP Korçë, mori pjesë në takimin e realizuar me nxënësit e shkollës së mesme “Themistokli Gërmenji” Korçë, në bashkëpunim me kordinatorën ndaj dhunës pranë Drejtorisë së Kujdesit Social.

Në datën 31.01.2024, QSHNJP Korçë, realizoi një aktivitet në zonën e Pazarit të Korçës, duke informuar qytetarët për shërbimet e ofruara nga Qendra e Ndihmës Juridike Parësore.



Vlorë

Në datën 16.01.2024, QSHNJP Vlorë, realizoi një takim pranë Njesisë Administrative Oriku. Ky aktivitet kishte në fokus informimin dhe promovimin e shërbimit ligjor falas, shërbimet e ndihmës juridike parësore dhe dytësore, etj.

Në datën 31.01.2024, QSHNJP Vlorë, realizoi një aktivitet ndërgjegjësues me qytetarë të Vlorës për promovimin e shërbimeve të QSHNJP Vlorë.





BULETINI INFORMATIV

JANAR 2024

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Fier

Në datën 24.01.2024, QSHNJP Fier, organizoi një takim, me pjesëmarrjen e Zj. E.Allkanjari, kordinatore për dhunën në familje në Drejtorinë Vendore Të Policisë Fier, si dhe qytetarëve, kategori të veçanta të ligjit Nr. 111/2017.

Në datën 31.01.2024, QSHNJP Fier, organizoi një takim në Qendrën Shëndetësore Nr.1 Fier së bashku me psikologjen e Qendrës.



Kukës

Në datën 31.01.2024, QSHNJP Kukës, organizoi një takim informues me qytetarët në zonat kryesore të qytetit për informimin mbi Ligjin 111/2017 "Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti".

Në datën 31.01.2024, QSHNJP Kukës, organizoi një takim informues në Njësinë Administrative Bicaq me punonjës të këtij insitucioni në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional përmes zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese.



Kurbin

Në datën 26.01.2024, QSHNJP Kurbin, organizoi një aktivitet në kuadër të fushatës ndërgjegjëse dhe informuese në bashkëpunim me Agjensinë e Sigurimeve Shoqërore Kurbin, me tematikë fuqizimin e komunitetit të Kurbinut dhe mbështetje të moshës së tretë më së tepërmi.



Lushnjë

Në datën 30.01.2024, QSHNJP Lushnjë, zhvilloi një aktivitet në bashkëpunim me Shërbimin Social, Bashkia Lushnjë, për të drejtat e grave e vajzave dhe kuadri ligjor i tyre.

Në datën 31.01.2024, QSHNJP Lushnjë, zhvilloi një aktivitet në qendër të qytetit Lushnje me qytetarë, me qëllim promovimin e ndihmës ligjore falas.



Pukë

Në datën 12.01.2024, QSHNJP Pukë, zhvilloi një aktivitet në bashkëpunim me kordinatoren e njësisë administrative Luf, zj. L.Ndoci, me temë sesjon informimi për hapjen e QSHNJP Pukë

Në datën 12.01.2024, QSHNJP Pukë, zhvilloi një aktivitet në bashkëpunim me kordinatoren e qendrës administrative Gjegan, z.Gj.Marku, si dhe me prezencën e disa qytetarëve, mbi funksionin e hapjes së QSHNJP Pukë



Mat

Në datën 08.01.2024, QSHNJP Mat, zhvilloi një takim informues në shkollën e mesme të bashkuar "Gjergj Kastrioti" në Njësinë Administrative Baz.

Në datën 08.01.2024, QSHNJP Mat, zhvilloi një takim informues në shkollën e mesme të bashkuar "Papa Gjon Pali i dytë" në Njësine Administrative Ulëz.

Në datën 16.01.2024, QSHNJP Mat, zhvilloi një aktivitet, ditë e hapur në qytetin e Klosit.

Në datën 18.01.2024, QSHNJP Mat, zhvilloi një takim informues pranë shkollës së mesme 28 Nëntori, Burrel.

Në datën 23.01.2024, QSHNJP Mat, zhvilloi një aktivitet informues në lagjen "Pjeter Budi".

